



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1442/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Acibadem Sistina Hospital” e regjistruar në Maqedoni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokate Delvina Nallbani nga Prishtina, kundër debitorit “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group” Sh.A – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, rruga Ukshin Hoti nr.13, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.436/22 i datës 18.08.2023, me datën 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group Sh.A – Dega në Kosovë me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.436/22 i datës 18.08.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Parë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group Sh.A – Dega në Kosovë me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.354/18, të datës 16.05.2018, të Përmbaruesit Privat Kushtrim Metaj, dhe ka lën në fuqi Urdhrin përmbarimor P.nr.354/18 i datës 16.05.2018 i Përmbaruesit Privat Kushtrim Metaj.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkalles së Dytë, aktvendimin e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.436/22 dt.18.08.2023, ta ndryshoj dhe miratoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group” i datës 22.05.2018, ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.354/18 dr.16.05.2018.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Acibadem Sistina Hospital" e regjistruar në Maqedoni, me datën 16.05.2018 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group Sh.A – Dega në Kosovë me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave. Përmbartuesi privat, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.354/18, të datës 16.05.2018, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga faturat t'i paguaj shumën 55,206.00€.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka kundërshtuar Urdhrin për përmbartim, me arsyetimin se faturat janë fiktive që vërtetohet edhe mungesa e nënshkrimit të debitorit, i propozon gjykatës që urdhrin përmbartimor ta anuloj si joligjor.

Kreditore me përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin me arsyetimin se urdhrin përmbartimor është lëshuar në bazë të dokumenteve të besueshme të cilat përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme, Me asnjë provë debitori nuk e ka provuar faktin se faturat janë anuluar, ndryshuar apo kanë humbur efektin juridik, i propozon gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, të Përmbartuesit Privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar urdhrin i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në faturat të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, ngase në to janë treguar palët përkatësisht kreditore dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat/shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Andaj marrë parasysh këto gjykata e shkallës e parë ka vendosë si në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditore, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave origjinale të lëshuara nga kreditore, të cila fatura në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe të njëjtat si të tilla paraqesin bazë juridike për

caktimin e përmbarimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbarim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* çka edhe Gjykata Shkalles e Dytë vlerëson se kreditori ka vepruar në pajtim me këtë nen, nga të cilat fatura të besueshme është caktuar përmbarimi.

Në rastin konkret Dhomat e Shkalles së Dytë, vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 të LPK dhe as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhomat e shkallës së dytë, po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturat, të cilat kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase faturat e lartcekura, në bazë të së cilave është caktuar përmbarimi, ligjërisht paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit, prandaj kjo gjykatë vlerëson se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij konform nenit 69 par.5 të LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP, prandaj vendosi që këto pretendime t'i refuzoj si të pabazuara.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II nr.1442/23 me datë 04.06.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha